



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 114, datë 06.06.2019

**PËR
MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE, NDAJ VLERËSUESIT TË DËMEVE NË
SIGURIME Z. AJET BAKIU**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 235 dhe nenit 152, pika 1, germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

BSHS, me shkresën nr. 1192 prot., datë 18.02.2019, ka depozituar në Autoritet disa akte vlerësimi të hartuar nga ky vlerësues dëmsh, me kërkesën për rishikimin e tyre nga Autoriteti për shkak se janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Z. Ajet Bakiu, vlerësues i pavarur i dëmeve në sigurime, licencuar me nr. 95 datë 25.06.2014, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime ka kryer akt vlerësim dëmi në disa variante për një ngjarje sigurimi.

Nga verifikimi i akteve të vlerësimit konstatohet se:

Akt vlerësimi për rastin me paaftësi të përhershme të z. Altin Marjani është bërë në dy variante, njëri sipas Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar dhe tjetri sipas Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar.

Në variantin e parë vlerësimi për të gjitha figurat e dëmeve është bërë në rregull, ndërsa sipas variantit të dytë, dëmi moral dhe ekzistencial janë llogaritur si figura të veçanta, ku vlera për secilën figurë është marrë ajo që në fakt sipas Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009, i takonte të ishte për të dyja bashkë.

Në takimin e organizuar pranë zyrave të AMF-së, në datën 18.03.2019, midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Zbatëshmërisë dhe vlerësuesit të pavarur z. Ajet Bakiu, nga ana e këtij të fundit është pretenduar se përlllogaritja e dëmit moral dhe ekzistencial si figura të ndara më vete, është kryer me kërkesën e palës dhe miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 152, pika 1) gërma a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhërohet vlerësuesi i pavarur z. Ajet Bakiu, si më poshtë:
 - i. Të kryejë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në përputhje me legjislacionin në fuqi në sigurime;
 - ii. Të bëjë vlerësime të paanshme duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi, sipas pikës 1, të nenit 233, të Ligjit nr. 52/2014.
2. Përsëritja e shkeljeve të mësipërme, do të jetë objekt i masave të përshkallëzuara konform legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për njoftimet dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI